



**KËRKESE PËR RIALOKIM NË TARIFËN E
SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES NË NIVEL
TENSIONI 35KV PËR VITIN 2017**

OSHEE sh.a.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Adresa : Njësia Nr.5, Rr. "Andon Zako Çajupi", Pall Conad, Kati III,
Tiranë,
Shqipëri

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	1
1.1	Vështrim i Përgjithshëm.....	1
1.2	Ndryshimet në Statusin Ligjor në kuadër të ndryshimeve në Tregun Energjistik.....	1
1.3	Përformanca e Shoqërisë 2014 – 2016.....	2
II.	PËRLLOGARITJA E KËRKESËS PËR TË ARDHURA PËR OPERATORIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE.	5
2.1	Përllogaritja dhe kufizimet.....	5
2.2	Sasia e energjisë për mbulimin e humbjes dhe kosto e transmetimit të saj.....	6
2.3	Shpenzimet Operative.....	6
2.4	Asetet, Investimet dhe amortizimi.....	7
2.5	Kosto e Kapitalit.....	8
2.6	E ardhura e Kërkuar.....	9
III.	PËRLLOGARITJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES NË NIVEL TENSIONI.	10

I. PËRMBLEDHJE

1.1 Vështrim i Përgjithshëm

Kërkesa për rialokimin në tarifën e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kv mbështetet në ligjin e ri “Për sektorin e energjisë elektrike” Nr. 43/2015 datë 30.04.2015 neni 19.b/20.c si dhe “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s” neni 21.

Theksojmë se OSHEE gjykon që tarifat dhe çmimet ekzistuese të miratuara nga ERE janë të mjaftueshme dhe nuk kërkon rishikimin të tyre në përgjithsi si për Operatorin e Shpërndarjes ashtu edhe atë të Furnizimit Universal sipas vendimeve të ERE nr. 147 dhe 148 datë 26.12.2014 në kushtet kur çmimi i blerjes së energjisë nga KESH dhe OST nuk ndryshon.

Në përlogaritjet e OSHEE, pa ndryshuar të ardhurat e kërkuara dhe tarifën mesatare të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas vendimit 147 përmendura më lart, rezultojnë se tarifa e miratuar sipas vendimit 146 datë 26.12.2014 është e pamjaftueshme dhe duhet të rialokohet brenda përlogaritjes së të ardhurës së kërkuar në llogaritjen e tarifës mesatare të shpërndarjes.

Dy vjet pas rishikimit të fundit të tarifave nga ERE, OSHEE ka tashmë një performancë ekonomike me përmirësim të jashtëzakonshëm dhe vazhdimësi të garantuar në një periudhë afatgjatë, kryesisht si rezultat i punës për uljen e humbjes dhe rritjes së arkëtimit, por edhe uljes së ndjeshme të kostove si ato të blerjes së energjisë nga importi dhe kostove operative.

Pavarësisht nga rezultatet në përmirësim të dukshëm gjendja ekonomike e OSHEE (vazhdim i CEZ Shpërndarje) vazhdon të jetë e vështirë. Kështu totali i pritshëm i detyrimeve sipas pasqyrës paraprake të Bilancit në fund të vitit 2016 pritet të jetë 93.2 miliard Lekë dhe gjendja në kapitalin e vet është (- 35.9) miliard Lekë.

1.2 Ndryshimet në Statusin Ligjor në kuadër të ndryshimeve në Tregun Energjitik

Ndryshimet e shpeshta në statusin ligjor të shoqërisë që nga krijimi i OSSH në vitin 2007, me privatizimin dhe kalimit të 74% aksioneve në pronësi të CEZ a.s. duke e kthyer atë në CEZ Shpërndarje, heqjen e liçences dhe kalimit të shoqërisë në administrim të përkohshëm nga ERE në fillim të vitit 2013 të cilat u shoqëruan edhe me përqendrim të treguesve ekonomikë – financiarë të shoqërisë janë stabilizuar tashmë dhe pas kalimit të 100% të aksioneve në pronësi të Shtetit Shqiptar në fund të vitit 2014, emërimeve të organeve të reja drejtore dhe ndryshimit të emrit të shoqërisë në OSHEE nga CEZ Shpërndarje, nuk ka patur ndryshime në statusin ligjor të shoqërisë.

Në zbatim të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.171 datë 25.02.2015 që miratoi Planin e Rimëkembjes së Sektorit Energjitik si dhe të planeve strategjike të vetë shoqërisë në kuadër të zbatimit të legjislativonit në fuqi dhe

ndryshimeve që ato sjellin në tregun e energjisë elektrike, shoqëria është futur tashmë në procesin e ndarjes administrative dhe menaxheriale të aktiviteteve të saj në plotësim të kërkesave të ligjit “Për Sektorin e Energjisë” për ndarjen e aktiviteteve të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike. Këto ndryshime do të sjellin sigurisht edhe ndryshime në statusin ligjor të shoqërisë që sipas kërkesës së ligjit duhet të përfundojnë përpara 31.12.2017.

Përgatitjet për ndarjen e shoqërisë, përkundrejt vazhdimin të punës për përmirësimin e treguesve ekonomikë – financiarë dhe menaxheriale, bazuar në aktiviteteve të licencuara është një proces që po zhvillohet nën këshillimin e konsulences dhe experiences më të mire të huaj dhe nën vëzhgimin dhe ndjekjen hap pas hapi në mënyrë të drejtëpërdrejtë të Qeverisë Shqiptare.

Zbatimi në praktikë i ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015 është duke u shoqëruar me plotësim të kuadrit ligjor sipas parashikimit ku më të rëndësishme janë Vendimi i Këshillit të Ministrave për Modelin e Tregut Nr.244, datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.” si dhe vendime të ERE për ndryshime në rregulloret në mbeshtetje dhe zbatim të ligjit dhe modelit të tregut.

Në zbatim të ligjit “Për Sektorin e Energjisë”, prej datës 1 Korrik 2016 OSHEE kryen aktivitetin e Furnizuesit Universal si dhe rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të licencuar nga ERE. Tashmë po punohet për përditësimin e Planit të Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike që Qeveria Shqiptare miratoi me vendim të Këshillit të Ministrave nr.171 datë 25.02.2015, në përputhje me arritjet e periudhës 2vjeçare në zbatim të tij ku fokusi kryesor do të vazhdojë të jetë përmirësimi i treguesve të performancës së OSHEE-s, reduktimi i humbjeve teknike dhe joteknike dhe rritja e normës së arkëtimit.

1.3 Performanca e Shoqërisë 2014 – 2016

Treguesit kryesorë të parashikuar për vitin 2016

Treguesit kryesorë të vitit 2016 (parashikim) në OSHEE krahasuar me ata të vitit 2015 paraqiten në tabelën më poshtë:

000/Leke	Pershkrimi	Realizimi	Realizimi	Realizimi	Diferenca 2016-2015	%
		2014	2015	2016		
Te ardhurat	Nga aktiviteti kryesor (shitja e Energjise)	42,931,151	49,765,384	50,630,493	↑ 865,108	102%
	Te tjera	4,321,125	4,779,383	2,386,857	↓ (2,392,526)	50%
	Gjithsej	47,252,276	54,544,767	53,017,350	↓ (1,527,418)	97%
Shpenzimet	Shpenzime Energji dhe Transmetim	34,198,681	30,382,726	25,540,118	↑ (4,842,608)	84%
	Shpenzime Operative	10,728,753	7,323,295	10,614,487	↓ 3,291,192	145%
	Provizione	309,332	(793,199)	717,673	↓ 1,510,872	-90%
	EBITDA	2,015,511	17,631,946	16,145,072	↓ (1,486,874)	
	Amortizimi	2,946,673	2,079,534	2,356,024	↓ 276,490	113%
	Shpenzime Financiare	1,144,290	1,337,347	1,437,708	↓ 100,361	108%
	Tatim Fitimi	2,435,034	2,770,167	1,852,701	↑ (917,466)	67%
	Gjithsej	51,762,761	43,099,870	42,518,711	↑ (581,159)	99%
REZULTATI I AKTIVITETIT	(4,510,485)	11,444,897	10,498,639	↓ (946,258)		
Te ardhura te Jashtezakoneshme	-	4,048,302				
REZULTATI I PERIUDHES	(4,510,485)	15,493,200	10,498,639	↓ (4,994,561)		
Investimet		698,830	2,952,796	10,061,005	↑ 7,108,209	
ENERGJI (MWH)						
	Energji e Blere	6,935,245	6,494,866	6,297,756	(197,110)	
	Energji e Shitur	4,313,304	4,459,444	4,534,384	74,940	
Humbje %		37.81%	31.34%	28.00%	↑ -3.34%	

Në tabelë:

- Fitimi real i vitit 2016 pritet të jetë rreth **35%** më i lartë se sa ai i vitit 2015 ose rreth **2.744** milion lekë, pasi në fitimin e vitit 2015 kanë ndikuar edhe faktorë që nuk lidhen me performancën e drejtëpërdrejtë të shoqërisë. Kështu në uljen e kostove të vitit 2016 kanë ndikuar ulja e provigjoneve nga arkëtimet e viteve të kaluara sipas vendimeve në ERE për 1.8 miliard Lekë, ulja e shpenzimeve për detyrime të pëllogaritura për çështje gjyqësore në vitin 2012 1.8 miliard Lekë si dhe nga të ardhurat e jashtëzakonshme prej 4 miliard Lekë. Tabela mw poshtw sqaron faktorët e jashtwm qw kanw ndikuar nw vitin 2015:

FAKTORË TË JASHTËM NË FITIMIN E VITIT 2015

FITIMI I VITIT	15,493,200
TË ARDHURA	4,048,302
Kamatvonesa me VKM	4,048,302
ZBRITJE NGA SHPENZIME TË VITEVE TË KALUARA	3,690,249
Shpenzime të jashtëzakonshme (DIA)	1,822,011
Rimarrje provigjone me sipas vendimeve të ERE	1,868,238
REZULTATI I AKTIVITETIT	7,754,649

- Puna për ndërprejren e lidhjeve të paligjëshme dhe uljen e humbjeve të cilat priten të jenë 3.34% më të ulta se në vitin 2015, është shoqëruar edhe me ulje të sasisë së energjisë në rrjet si pasojë e përdorimit me kursim nga ana e konsumatorëve, por megjithatë sasia e energjisë së shitur pritet të rritet me 1.7% ose rreth 75 GWh.
- Të Ardhurat nga Shitja e Energjisë pritet të rezultojnë 2% më të larta ose 865 milion Lekë.
- Të ardhurat gjithsej janë 3% më të ulta si pasojë e uljes të kamatevonesave krahasuar me 2015. Arkëtimet e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2015 ishin rezultat i fillimit të aksionit për uljen e humbjeve. Tashmë për pjesën më të madhe të detyrimeve janë lidhur kontrata duke ristrukturuar detyrimin dhe falur pjesërisht kamatevonesat.
- Përmirësimi kryesor në treguesit financiarë të vitit 2016 lidhet me performancën në blerjen e energjisë krahas uljes së humbjes e cila ka siguruar një kursim prej 4.8 miliard Lekë.
- Rritja reale e shpenzimeve operative pritet të jetë vërtetë 74% e asaj të buxhetuar si pasojë e ndryshimeve në planet e disa aktiviteteve dhe kursimin e vazhdueshëm megjithatë ka një rritje reale prej rreth 1.5 miliard Lekë në krahasim me vitin 2015 i cili ka patur edhe influencën e një zvogëlimi të shpenzimeve ligjore prej vitit 2012 prej 1.8 miliard Lekë.
- Arkëtimet pritet të jenë sa 94% e vlerës së faturuar e cila është 2% më e lartë se sa ajo e paraparë në buxhet si dhe në Planin e Rimëkëmbjes prej 92%. Kjo do të sjellë provigjionime prej rreth 0.7 miliard Lekë. Ndërsa në vitin 2015 si vit i parë i aksionit për uljen e humbjeve, arkëtimi ishte 100% dhe në vlerën e provigjionimit u bë një ulje prej rreth 1.8 miliard Lekë me vendim të ERE.
- Realizimi i pritshëm i investimeve prej rreth 10.06 miliard Lekësh është më i madhi i realizuar ndonjëherë në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, i cili pritet të ulë humbjet në shitjen e energjisë elektrike. Këto investime kanë sjellë edhe rritje të amortizimit prej rreth 276 milion Lekë.
- Në vitin 2016 nuk ka patur të ardhurat të jashtëzakonshme si ato të realizuara në vitin 2015 prej rreth 4 miliard Lekë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave për shuarjen së detyrimeve ndërmjet OSHE, KESH dhe detyrimeve të klientëve buxhetorë dhe jobuxhetorë.
- Rritja prej 8% e shpenzimeve financiare lidhet kryesisht me ndryshime në normat e këmbimit për kreditë e trashëguara në monedha të ndryshme.

II. PËRLLOGARITJA E KËRKESËS PËR TË ARDHURA PËR OPERATORIN E SHPËNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE.

2.1 Përllogaritja dhe kufizimet.

Në zbatim të metodologjisë e cila bazohet në përllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara të Operatorit të Shpërndarjes për vitin 2017 kemi marrë në konsideratë supozimet themelore si vijon:

- i. Çmimet për Furnizuesin Publik me Shumicë dhe OST me të cilat KESH dhe OST i shesin energji dhe transmetim OSHEE janë të njëjta me ato të vitit në vazhdim 2015 dhe nuk kanë asnjë efekt të shtuar në përllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara si për Shpërndarjen e Energjisë nga OSHEE.
- ii. Çmimi i energjisë për mbulimin e humbjeve bazohet në parashikimin sipas monitorimit të tregut 2015 dhe që mund të ndryshojë duke u llogaritur si kompensim në vitet e ardhshme të përllogaritjes së tarifave të ë të energjisë.
- iii. Përllogaritja e kërkesës për energji është bazuar gjithashtu në strukturën aktuale dhe parashikimin për vitin në vazhdim por që në varësi të ndryshimeve në treg mund të jetë gjithashtu objekt i kompensimeve për diferenca në periudha të tjera.
- iv. Zhvillimet pozitive të ekonomisë Shqiptare janë marrë parasysh në mosllogaritjen e ndonjë faktori jo pozitiv në provigjionime të mundshme për efekte të raporteve të paqëndrueshme inflative të ekonomisë që mund të përkthehet në rreziqe të rritjes së menjëhershme të shpenzimeve.

Sasia e energjisë së injektuar në sistem për vitin 2017 parashikohet të jetë 6,153 GWH. Sasia e energjisë së shitur parashikohet të jetë 4,615 GWH dhe sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve parashikohet të jetë 1,538 GWH duke parashikuar që niveli i humbjeve të jetë 25%.

Megjithë investimet e mëdha të realizuara në vitin 2015 – 2016 mungesa e investimeve në rrjet është akoma e ndjeshme. Kjo nevojë lidhet jo vetëm me përmirësimet teknologjike të nevojshme në drejtim të cilësisë së shërbimit, por shpesh thjesht dhe vetëm me zëvendësimin e makinerive dhe paisjeve të cilat kanë mbaruar tërësisht ciklin e jetës. Këto nevoja përcaktojnë një periudhë të gjatë strategjike investimi për të cilin vitet 2015 - 2016 janë vetëm vite të fillimit dhe do të vazhdojnë me një intensitet të ngjashëm deri në vitin 2021. Mbështetja kryesore për investimet në vitet e ardhshme mbetet financimi me burime të brendshme si dhe ato me ndërhyrjen e Bankës Botërore. Investimet për vitin 2017 mbështetur në burime të brendshme të kompanisë dhe në këtë kredi do të jenë 14.3 miliard Lekë.

Nga përllogaritjet si më poshtë kërkesa për të ardhura për Operatorin e Shpërndarjes në vitin 2017 është rreth 21.9 miliard Lekë.

2.2 Sasia e energjisë për mbulimin e humbjes dhe kosto e transmetimit të saj.

Llogaritja e nevojave për energji është bazuar në metodologjinë e përlogaritjes së saj e cila ka marrë parasysh: a) nevojat në rritje të konsumit bazuar në rritjen ekonomike të pritëshme 2017; b) uljen e humbjeve nga shitja e energjisë elektrike (teknike dhe jo teknike) c) parashikimi i motit etj.

Parashikimi i sasisë së enegjisë në rrjet dhe humbjet për vitin 2017 paraqiten në tabelën që vijon:

Projeksioni i Energjise Totale te Blere per OSHEE gjate Vitit 2017

Viti 2017	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nent	Dhjet	Total
Energji e Blere	656	547	560	459	467	453	498	502	441	459	501	610	6,153
Energji e Shitur	444	403	406	356	355	357	386	393	359	354	369	434	4,615
Humbje Gwh	213	144	154	103	112	96	112	109	82	105	132	177	1,538
Humbje %	32.4%	26.4%	27.5%	22.3%	24.0%	21.1%	22.5%	21.8%	18.6%	22.9%	26.3%	28.9%	25.0%

2.3 Shpenzimet Operative

Administrimi i shoqërisë i ka kushtuar rëndësi të madhe kursimit për çdo zë të shpenzimeve megjithatë është ndeshur me nevojën e menjëhershme të tyre për të rritur performancën duke ushtruar një kontroll më të madh mbi asetet në rrjet dhe përdorimin e tyre duke ndikuar në uljen e humbjeve. Në këtë këndvështrim ka një rritje të planifikuar të shpenzimeve për vitin në vazhdim 2016. Kosto e humbjeve dhe detyrimeve të trashëguara kanë sjellë shpenzime për penalitete të cilat rëndojnë shpenzimet operative të kompanisë të cilat pavarësisht metodologjisë do të duhet të pranohen si shpenzime operative të paktën pjesërisht.

Shpenzimet operative të krahasuara (pa penalitetet) për periudhën 2015 – 2017 paraqiten në tabelën në vazhdim:

Grupi i Llog	OSHEE OPEX (000 / ALL)	2015	2016	2017
			Parashikim	Buxhet
C01	Shpenzime materiale dhe konsumi	293,899	297,157	322,582
C20	Shpenzime për personelin	4,170,057	4,967,933	6,424,609
C50	Mirembajtje	1,389,754	1,417,685	2,034,954
C92	Maredhenie me Publikun dhe Marketing	94,944	109,735	109,735
C94	Sherbime Postare dhe Komunikimi	591,543	681,528	681,528
C95	Shpenzime Teknologjia e informacionit	36,351	55,579	55,579
C96	Shpenzime Ligjore	94,062	290,543	290,543
C97	Konsulence dhe Auditim	84,480	200,000	200,000
C90	Te tjera	709,467	848,270	1,480,453
	Totali i Shpenzimeve Operative	9,145,306	9,263,929	12,087,032

Rritja e ndjeshme e shpenzimeve lidhet kryesisht me shpenzime për personelin jo manaxherial pagat e të cilave nuk ishin rritur apo indeksuar prej vitesh dhe janë aprovuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në muajin Gusht 2016.

Ristrukturimi në OSHEE është një proces në vazhdim dhe do të përfundojë në muajt e parë të vitit 2017. Sipas strukturës së tanishme të organizimit të shoqërisë është akoma i pamundur evidentimi i ndarë i shpenzimeve operative për Shpërndarjen dhe Shitjen prandaj për ndarjen e tyre kemi përdorur sërish koeficientët e përafuar sipas tabelës më poshtë:

000/Lekë	2015	2016	2017
OPEX Shpërndarje	7,246,995	7,340,995	9,578,101
OPEX Shitje	1,898,311	1,922,934	2,508,931
TOTAL OPEX	9,145,306	9,263,929	12,087,032
% Shitje	20.76%	20.76%	20.76%
% Shpërndarje	79.24%	79.24%	79.24%

2.4 Asetet, Investimet dhe amortizimi

Përmirësimi i performancës së shoqërisë në 2 vitet e fundit ka krijuar mundësi financiare për rritjen e investimeve të cilat po kryhen vetëm me burime të brendshme të shoqërisë për vitin 2016 dhe do të vazhdojnë të mbështeten kryesisht në këto burime edhe për vitin 2017 ku pritet të ketë edhe realizim të investimeve me mbështetjen e Bankës Botërore.

Vazhdimi intensiv i investimeve drejtohet kryesisht në:

- Vazhdimin e zëvendësimit të rrjetit 6/10 kV me rrjetin me tension 20 kV.
- Zëvendësimi i rrjeteve TU me përcjellësa ajror të zhveshur me përcjellësa ajror të izoluar me vetëmbajtje ABC
- Ndërtimi i nënstacioneve elektrike 110/20 kV
- Investime në teknologjinë e informacionit.

Tabela e ndryshimeve në vlerën e aseteve dhe amortizimi për vitin 2017 parashikohen në tabelën në vijim:

	Pershkrimi	Vlera bruto 31.12.2016	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
208000	Te tjera AAGJ - JM	231,585,413	-	15,561,595	231,585,413	143,403,040	88,182,374
208100	Software	401,654,084	338,233,000	77,963,282	739,887,084	128,978,652	610,908,432
211000	Toka	1,030,908,742	440,200,000	-	1,471,108,742	-	1,471,108,742
211100	Permirësimi i Tokave	763,841,690	-	15,658,217	763,841,690	466,335,562	297,506,128
212000	Ndërtesa dhe konstruksione	3,171,429,329	619,207,153	107,571,079	3,790,636,481	1,437,182,397	2,353,454,084
213000	Makineri dhe pajisje	41,419,194,428	12,702,511,588	3,025,822,988	54,121,706,016	22,830,987,187	31,290,718,829
215000	Mjete transporti	429,219,467	-	10,340,736	429,219,467	387,856,523	41,362,944
218100	Pajisje Zyre	182,409,745	190,000,000	28,842,660	372,409,745	162,039,105	210,370,640
218200	Pajisje IT	1,945,836,222	-	306,283,116	1,945,836,222	1,026,986,875	918,849,347
	TOTAL	49,576,079,120	14,290,151,741	3,588,043,674	63,866,230,861	26,583,769,342	37,282,461,519

Vlera bruto e aseteve në OSHEE pritet të arrijë 63.9 miliard Lekë në fund të vitit 2017.

2.5 Kosto e Kapitalit

Tabela më poshtë tregon parashikimin e gjendjes së kredive në fund të vitit 2017:

Nr	Emertimi i Kredise	Norma interesit	Monedh	Interesi ne Leke	Principali me 31.12.17 ne Leke	Principali me 31.12.17 ne Valute
1	PTDP JBIC ABA	2.30%	JPY	34,716,591	1,393,405,903	1,333,402,778
2	EDCF - ALBKO Babica Project	3.00%	KRW	19,410,613	612,702,086	5,715,504,530
3	Fieri Distribution project	0.30%	USD	3,511,226	1,145,506,298	9,106,497
4	PTDP - IDA (1) Credit 2826 Alb	3.13%	XDR	1,241,270	0	0
5	Power Loss reduction 2677(Gov.AL)	3.13%	USD	386,290	0	0
7	Italian Cooperation (ITC5) (13.02.2003)	0.40%	EUR	4,001,852	1,000,462,910	7,287,754
9	Emergency intervention AID98	1.00%	EUR	1,551,099	146,671,256	1,068,410
10	March 2000	0.25%	EUR	3,017,135	1,206,854,000	8,791,186
11	Commodity Aid VII Power Supply of Korca	0.75%	EUR	4,012,565	517,796,145	3,771,825
12	Power Supply of Southern Albania	0.75%	EUR	7,467,785	968,372,940	7,053,999
14	Bushat substation (BEI 21264)	4.77%	EUR	15,687,120	305,730,843	2,227,060
Shuma pagesava per Huate nga KESH sha				95,003,546	7,297,502,381	
15	Detyrimi ndaj CEZ AS	3.79%	EUR	210,228,121	2,894,319,913	21,083,333
Shuma pagesava per Detyrimin ndaj CEZ AS					3,104,548,034	
Kosto totale e pagesave per periudhen 2016-2020				305,231,667	10,191,822,294	

Norma e interesit të borxhit të vjetër rezulton **1.23%**.

Norma e interesit të borxhit të ri **3.63%**.

Norma mesatare e interesit **2.26%**.

Përllogaritja e kthimit të lejuar të kapitalit ka marrë parasysh normën e kthimit të bonove të thesarit **2%** si dhe normën për riskun e vendit Beta në investime **6%**.

Pesha mesatare e ponderuar e kapitalit paraqitet në tabelën që vijon:

Norma e interesit te borxhit te vjeter	1.23%
Norma e interesit te borxhit te ri	3.63%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	8.00%
Borxhi I vjeter %	42.96%
Borxh I ri %	17.04%
Raport I synuar I kapitalit te vet	40.00%
Kthim per borxhin e vjeter	0.53%

Kthim per borxhin e ri	0.62%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	3.20%
WACC	4.35%

2.6 E ardhura e Kërkuar

Në përlllogaritjen e të ardhurës së kërkuar janë marrë parasysht edhe të ardhura të tjera të planifikuara për vitin 2017 të cilat janë zbritur. Kështu janë zbritur të ardhurat nga shitja e energjisë reaktive prej rreth 330 milion Lekë si dhe të ardhurat nga lidhjet e reja prej rreth 375 milion Lekë.

Llogaritja e së ardhurës së kërkuar për vitin 2017 për Operatorin e Shpërndarjes paraqitet në tabelën që vijon:

Zeri	2017
Shpenzime Operative	9,578,101
Kosto e transmetimit per humbjet	703,649
Kosto e humbjeve	7,506,480
Total OPEX	17,788,231
Vlera e investimeve ne v. 2011	35,502,006
Vlera e investimeve ne v. 2012	765,883
Vlera e investimeve ne v. 2013	448,465
Vlera e investimeve ne v. 2014	1,208,133
Vlera e investimeve ne v. 2015	1,626,099
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2016	10,061,005
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2017	7,145,076
Vlera e asetëve Gjithsej	56,756,666
minus:Amortizimi i akumuluar	(26,583,769)
vlera e RAB per 2011 pa perfshire kapitalin e punes	30,172,897
Kapitali I punes	1,482,353
RAB	31,655,250
Norma e interesit te borxhit te vjeter	1.23%
Norma e interesit te borxhit te ri	3.63%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	8.00%
Borxhi I vjeter %	42.96%
Borxh I ri %	17.04%
Raport I synuar I kapitalit te vet	40.00%
Kthim per borxhin e vjeter	0.53%
Kthim per borxhin e ri	0.62%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	3.20%
WACC	4.35%
Fitimi	1,376,022
Amortizimi I vitit	3,588,044
Te ardhura nga lidhjet e reja	(375,677)
te ardhurat nga energjia reaktive	(329,043)
Kompensim per humbjet 2012 - 2014	
Totali i te Ardhurave te Kerkuara	22,047,577
Energji e levruar ne rrjetin e shperndarjes MWH	4,615,029
Tarifa mesatare e shperndarjes Lekw/KW	4.78

III. PËRLLOGARITJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË SHPËNDARJES NË NIVEL TENSIONI

Përlllogaritja e tarifës së shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni, bazohet kryesisht në koeficientë të gjetur të alokimit të shpenzimeve dhe jo në matjen e tyre të drejtpërdrejtë. Vështirësitë e kalkulimit të drejtpërdrejtë lidhe me faktorët si më poshtë:

- i. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë megjithë investimet e viteve të fundit është akoma i rrënuar dhe si i tillë është gati e pamundur të përcaktohen qartë kostot oportune të investimeve të nevojshme për sjelljen e tij në parametra të transmetimit cilësor, prandaj përlllogaritja e kostos së transmetimit për nivel tensioni mund të përmbajë në çdo kohë koeficientë të përafritim vlera e të cilit, mund të jetë e diskutueshme metodologjikisht.
- ii. Vetë rrjeti i shpërndarjes së energjisë si pasojë e mungesës së vazhdueshme të investimeve dhe ndërhyrjeve të shpeshta në kushtet e emergjencave është shumë i paqartë, qoftë për ndarjen sipas peshës specifike të përdorimit të tij nga paisjet sipas nivelit të tensionit ashtu edhe në përcaktimin e humbjeve për çdo nivel tensioni.
- iii. Sistemi i informacionit (marrjes së të dhënave) për kostot e drejtpërdrejta dhe ato që do të duhet të alokohen në programin financiar SAP nuk është ndërtuar i tillë që të detajojë në mënyrë të qartë këto informacione. Nuk ka akoma ndarje organizative ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit Universal. Për t'u ridetajuar do të duhet akoma disa muaj kohë dhe përgatitje e posaçme.
- iv. Përlllogaritja e përgatitur më poshtë është mbështetur në Kërkesën për të Ardhura dhe Çmimin e importit të energjisë për mbulimin e kostos së humbjeve teknike gjatë shpërndarjes.
- v. Alokimi sipas koeficientëve të llogaritur mbi bazë të energjisë së shitur për nivel tensioni dhe niveli i humbjeve të njohura për çdo nivel tensioni, kanë qenë baza për shpërndarjen e shpenzimeve operative, shpenzimeve për humbjet e energjisë elektrike në rrjet dhe vlerës së Aseteve Bazë të Rregulluara si bazë për llogaritjen e të ardhurave për mbulimin e kostos së kapitalit.

Nga përlllogaritjet në zbatim të metodologjisë dhe koeficientëve të shpërndarjes (alokimit) rezulton se tarifa për tensionin 35 kV duhet të jetë 2.31 Lekë/kw, për tensionin 20 – 6 kV 3.95 Lekë /kw dhe për tensionin e ulët 4.99 Lekë/kw. Megjithatë në rast se raporti i shitjes në bazë tensioni ndryshon, ndryshon edhe baza e shpërndarjes (alokimit) dhe përlllogaritjet duhet të ndryshojnë tërësisht.

Koeficienti i Shpërndarjes bazuar në strukturën e shitjes dhe humbjet e vitit 2016

Në kushtet e mungesës së informacionit të detajuar për të llogaritur saktësisht tarifat për nivel tensioni sikurse është përmendur më lart, për përlllogaritjen e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2016 jemi bazuar në:

- a) Kërkesën për të ardhura të vitit 2017 të llogaritur për operatorin e shpërndarjes sipas përlllogaritjeve si më sipër.
- b) Koefficientëve të shpërndarjes së shpenzimeve (alokimit) që marrin parasysh sasinë e energjisë së shitur sipas strukturës, strukturën e aseteve sipas nivelit të tensionit dhe humbjet e energjisë sipas nivelit të tensionit.

Niveli i Tensionit	Viti2016	%	Humbjet %
	KWH		
35 kV	53,651	1.18%	0.76%
20 kV	295,378	6.51%	1.70%
10 - 6 kV	500,014	11.03%	9.40%
I ulët 0.4 kV	3,685,341	81.28%	88.14%
Total	4,534,384		100.00%

Humbjet teknike për vitin 2017 janë parashikuar 19.2%

Humbjet Teknike

Tensioni	Humbjet%
35kV	6.60%
20kV	2.70%
10-6 kV	8.80%
0.4 kV	11.20%
Total	19.20%

Tabela më poshtë paraqet tabelën e llogaritjes së tarifës 2017 në nivel tensioni:

Tarifat e Operatorit të Shpërndarjes për nivel tensioni 000/Lekë

Zeri	2017	Tension i Mesem 35 kV	Tension i Mesem 20-6 kV	Tension i Ulet 0.4 kV
Shpenzime Operative	9,578,101	23,144	1,711,411	7,842,548
Kosto e transmetimit per humbjet	703,649	5,321	78,102	620,227
Kosto e humbjeve	7,506,480	56,762	833,185	6,616,533
Total OPEX	17,788,231	85,226	2,622,698	15,079,308
Vlera e investimeve ne v. 2011	35,502,006			
Vlera e investimeve ne v. 2012	765,883			
Vlera e investimeve ne v. 2013	448,465			
Vlera e investimeve ne v. 2014	1,208,133			
Vlera e investimeve ne v. 2015	1,626,099			
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2016	10,061,005			
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2017	7,145,076			
Vlera e aseteve Gjithsej	56,756,666	671,548	9,955,891	46,129,227
minus:Amortizimi i akumuluar	(26,583,769)	(314,541)	(4,663,154)	(21,606,074)
vlera e RAB per 2011 pa perfshire kapitalin e punes	30,172,897	357,008	5,292,736	24,523,153
Kapitali I punes	1,482,353	7,102	218,558	1,256,609
RAB	31,655,250	364,110	5,511,294	25,779,762
Norma e interesit te borxhit te vjeter	1.23%	1.23%	1.23%	1.23%
Norma e interesit te borxhit te ri	3.63%	3.63%	3.63%	3.63%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	8.00%	8.00%	8.00%	8.00%
Borxhi I vjeter %	42.96%	42.96%	42.96%	42.96%
Borxh I ri %	17.04%	17.04%	17.04%	17.04%
Raport I synuar I kapitalit te vet	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%
Kthim per borxhin e vjeter	0.53%	0.53%	0.53%	0.53%
Kthim per borxhin e ri	0.62%	0.62%	0.62%	0.62%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	3.20%	3.20%	3.20%	3.20%
WACC	4.35%	4.35%	4.35%	4.35%
Fitimi	1,376,022	15,827	239,570	1,120,621
Amortizimi I vitit	3,588,044	35,954	635,892	2,916,198
Te ardhura nga lidhjet e reja	(375,677)	(4,445)	(65,899)	(305,333)
te ardhurat nga energjia reaktive	(329,043)	(8,478)	(291,329)	(29,235)
Kompensim per humbjet 2012 - 2014				
Totali i te Ardhurave te Kerkuara	22,047,577	124,085	3,140,932	18,781,558
Energji e levruar ne rretin e shperndarjes MWH	4,615,029	53,651	795,393	3,765,985
Tarifa mesatare e shperndarjes Lekw/KW	4.78	2.31	3.95	4.99

IV. PROPOZIM I OSHEE PËR TARIFAT NË NIVEL TENSIONI PËR VITIN 2017

Bazuar në përlogaritjet sa më sipër OSHEE propozon që tarifat në nivel tensioni për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për vitin 2017 të jenë si në tabelën në vijim:

Lekë/Kwh	Tension i Mesem	Tension i Mesem	Tension i Ulet
	35 kV	20-6 kV	0.4 kV
Tarifa e shpërndarjes	2.31	3.95	4.99